



Pranuar / Dorezuar Punëjeto/Prodato Received/Delivered	22-04-2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM8HCK	2359/2022		1/5



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.304/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-Kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.1374/2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën A.nr.145/2020 të datës 15.05.2020, të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ ne adresë \_\_\_\_\_

Prishtinë, kundër Vendimit Ref: SBNJD-107/2020 të datës 14.04.2020, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Agjencisë Pyjore të Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 22.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.145/2020 e datës 15.05.2020 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_

II. Mbetet në fuqi Vendimi Ref: SBNJD-107/2020 i datës 14.04.2020, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë Pyjore të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi \_\_\_\_\_ i punësuar në Agjencinë Pyjore të Kosovës, me datë 15.05.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 897/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit Ref: SBNJD-107/2020 të datës 14.04.2020, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë Pyjore të Kosovës, për shkak të shkeljeve të rregullave dhe parimeve të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbim Civil.

Bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me datë 01.06.2020 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit të Agjencia Pyjore e Kosovës. Ndërsa me datë 11.06.2020 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë me numër protokoli 1134/2020 se bashku me provat e bashkangjitura.

Këshilli në mungesë të kuorumit për vendosje, përmes shkresës me numër protokoli 1359/2020 të datës 15.07.2020 ka njoftuar ankuesin lidhur me pamundësinë e shqyrtimit dhe vendosjes së ankesës së tij të datës 15.05.2020, dhe njëherit ka udhëzuar të njëjtin për ushtrimin e mjeteve juridike në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrative.

Pas këtij njoftimi të Këshillit, ankuesi ka hapur konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, e cila me Aktgjykimin A.nr.1374/2020 të datës 25.03.2022 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, ka anuluar Njoftimin e Këshillit të datës 15.07.2020 dhe ka detyruar të njëjtin që brenda tridhjetë (30) ditësh të vendos për ankesën e ankuesit të datës 15.05.2020.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 15.05.2020 me numër protokoli 897/2020 të parashtruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimit Ref: SBNJD-107/2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të datës 14.04.2020; Ankesën e ankuesit të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të datës 13.03.2020; Vendimin me numër Ref:SBNJD-32/2020 të Komisionit Disiplinor i datës 11.02.2020; Vendimin e Agjencisë Pyjore të Kosovës i datës 02.08.2019 me Referencë: DQIPGJ-328/2019; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore të 04.10.2019 më numër:4015; Deklaratën e datës 20.09.2019 me numër prot:354/19; E-mailin e datës 19.09.2019 dërguar ankuesi për Procesverbalin e Inspektoratit qendror të pyjeve me shifër 001001 të datës 19.07.2019; Procesverbalin e Inspektoratit qendror të pyjeve me shifër 001002 të datës 10.07.2019; Procesverbalin e Inspektoratit qendror të pyjeve me shifër 001005 të datës 19.07.2019; Procesverbalin e Inspektoratit qendror të pyjeve me shifër 001010 të datës 06.08.2019; Kërkesën për fillimin e procedurës për kundërvajtje të datës 07.08.2019 me numër Ref: DQIPGJ-341/19; Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinës më numër K.Nr.1713/2019; Lejen për prerjen e drunjëve (trungjeve) në pyllin privat e datës 18.06.2019 me numër Nr:22/19; Tabelën e specifikacionit të shpenzimit të bllokut për pyje private prej tetë (8) faqesh; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 01.06.2020; Fletë kthesën e datës 05.06.2020; Njoftimin e datës 10.07.2020; Njoftimin e datës 15.07.2022; Përgjigjen në kërkesë të datës 11.06.2020 me numër prot:1134/2020; Akt emërimin e ankuesit të datës 26.04.2013 me numër: ZPD-128/013; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Inspektor i Pylltarisë në APK; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2018 i datës 28.12.2018; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2019 i datës 13.01.2020; Kopjen e zarfit të datës 11.03.2020 me shifër: R8864617; Njoftimin për prerje pylli të datës 05.07.2019 me numër PR/APK391/2019; Njoftimin e datës 04.07.2019 me numër Ref: PR/APK-300/19; Kopjen e librit të damkosjes së trungjeve për prerje në pyje private me numër Ref: PR/APK-266/19 i datës 29.05.2019 në përmbajtje prej pesëmbëdhjetë (15) faqesh; Procesverbalin me numër serik 001001 i datës 09.07.2019; Procesverbalin me numër serik 001002 i datës 10.07.2019; Procesverbalin me numër serik 001005 i datës 19.07.2019; Shkresën e datës 30.07.2019 me referencë: PR/APK-436/2019; Aktin përcjellës të datës 30.07.2019 me numër prot:334/19; Deklaratën e datës 22.07.2019; E-mailin e datës 31.07.2018 dërguar nga

për E-mailin e datës 16.07.2018 dërguar nga për Kërkesën për sqarim ligjor të datës 19.07.2018; E-mailin datës 31.07.2018 dërguar nga për për Thirrjen për shqyrtim kryesor nga Gjykata Themelore në Prizren e datës 05.08.2019; Procesverbalin e vazhdimin të shqyrtimit gjyqësor i Gjykatës Themelore në Prizren i datës 23.09.2019 me aktvendimin e bashkangjitur më numër të lëndës: 2018-066790; Kërkesën për deklaram me shkrim e datës 17.09.2019; Njoftimin e datës 02.10.2019 me referencë: DQIPGJ-366/19; Raportin mjekësor të datës 18.09.2019; Shenjat e mjekut për pushim mjekësor të datës 18.09.2019; Njoftimin e datës 31.05.2019 me numër prot:217/19; Shkresën përcjellëse për vendim e datës 14.07.2015; Shkresën përcjellëse për vendim e datës 12.09.2019; Vendimin e datës 14.07.2015 me shifër: Ref, DQIPGJ-APK, 459/15; Kërkesën për pushim të datës 25.07.2019; Evidencën e vijueshmërisë në unë e datës 31.07.2019 si dhe datës 01.08.2019; Ftesën për seancë të Komisionit Disiplinor e datës 03.02.2020; Vërejtjen me shkrim të datës 28.05.2019 me numër prot:216/2019; Procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor të datës 05.02.2020; Procesverbalin e seancës së Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të datës 06.04.2020; Zarfin e postës të datës 09.08.2020 me numër R8956450.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale lidhur me çështjen në shqyrtim, ka konstatuar se është e pabazuar ankesa e ankuesit  
sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës gjegjësisht sipas Akt Emërimit ZPD-128/13 të datës 26.04.2013, rezulton se ankuesi është i sistemuar në pozitën *Inspektor i Pylltarisë* në Drejtorinë e Inspektoratit të Pylltarisë dhe Gjuetisë në kuadër të Agjencisë Pyjore të Kosovës. Ndaj të njëjtit Drejtori i Drejtorisë së Inspektoratit të Pylltarisë dhe Gjuetisë me datë 04.10.2019 përmes shkresës me numër 4015 ka iniciuar procedurë disiplinore me arsyetimin se i njëjti ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës.

Komisioni Disiplinor i Agjencisë Pyjore të Kosovës me Vendimin Ref:SBNJD-32/2020 të datës 11.02.2020 ka shpallur ankuesin përgjegjës për shkeljet të Ligjit Nr. 03/L-29 të Inspektionit Bujqësor, si dhe nenin 52 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenin 6 paragrafin 1 pika 1.10 të Rregullores Nr.04/2011 për procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil dhe nenin 4 paragrafi 1 pika 1.4 dhe 1.6, nenin 5 paragrafi 2, 4 dhe 5 si dhe nenin 10 paragrafin 1 të Rregullores Nr.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes për Shërbyesit Civil, duke shqiptuar masën disiplinore "*Pezullim i detyrave dhe ndalimi i 1/3 të rrogës për periudhën një mujore*".

Kundër vendimit të Komisionit Disiplinor Ref:SBNJD-32/2020 të datës 11.02.2020, ankuesi me datë 13.03.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë Pyjore të Kosovës, ndërsa ky i fundit më datë 14.04.2020 me Vendimin Ref: SBNJD-107/2020 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar.

Në ankesën e parashtruar në Këshilli, ankuesi pretendon se vendimi i goditur me ankesë është nxjerr me shkelje të rregullave dhe parimeve të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbim Civil, duke shtuar se iniciimi i procedurës disiplinore nuk është bërë nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit së iniciimi i procedurës disiplinore nuk është bërë nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë, Kolegji konstaton së kërkesa për iniciim të procedurës disiplinore ndaj

ankuesit është bërë me datë 04.10.2019 nga Drejtori i Drejtorisë së Inspektoratit të Pylltarisë dhe Gjuetisë i cili nuk është udhëheqës i drejtpërdrejtë i ankuesit, mirëpo meqenëse në këtë periudhë kohore ka qenë në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili ishte i zbatueshëm nga data 11.09.2019 deri me datë 20.11.2019 kur i njëjti ishte pezulluar nga Gjykata Kushtetuese deri me 09.07.2020, andaj në këtë kuptim dhe bazuar në nenin 48 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *4. Komisioni disiplinor fillon procedurën: 4.1. me kërkesë të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit civil; 4.2. me rekomandim të çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditimi, ose të çdo zyrtari tjetër me detyra kontrolli hierarkik mbi nëpunësin civil, si dhe me kërkesën e qytetarit;...* Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit si me lartë është i pa bazuar, ngase Drejtori i Drejtorisë së Inspektoratit të Pylltarisë dhe Gjuetisë konsiderohet zyrtar i kontrollit hierarkik mbi nëpunësin civil.

Po ashtu Kolegji bazuar në shkresat e lëndës verën se procedura disiplinore është zhvilluar bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, pasi që Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ishte pezulluar nga Gjykata Kushtetuese.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore Kolegji ju referua nenit 64 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil i cili ka përcaktuar se: *1. Nëpunësit civilë janë përgjegjës për çfarëdo shkelje të parimeve të përcaktuara sipas këtij ligji. 2..... 3. Nëpunësit civilë të cilët tregojnë pakujdesi të rëndë në respektimin dhe zbatimin e ligjeve dhe të akteve nënligjore të shërbimit civil, do t'u nënshtrohen masave disiplinore.,* si dhe nenit 66 paragrafi 1 me të cili parashihet se: *...Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuar nga sjellja e nëpunësit civil. Rastet e shkeljeve jashtëzakonisht të rënda përcaktohen me akt nënligjor, dhe si rrjedhojë Kolegji bazuar në provat e lëndës ka vlerësuar se Komisioni Disiplinor ka vërtetuar drejt gjendjen faktike duke konstatuar saktë përgjegjësinë disiplinore të ankuesit pasi që i njëjti me datë 02.08.2019 ka lëshuar Vendimin me numër Ref:DQIPGJ-328/2019 përmes të cilës palës i ka mundësuar të pres rreth 1000 m<sup>3</sup>/kub drunjë, ndërsa pala sipas lejes së prerjes ka pasur të drejtë të pres drunjë vetëm në masën prej 663.90 m<sup>3</sup>/kub. Andaj, bazuar në këtë konstatim Kolegji vlerëson se Komisioni Disiplinor ka cilësuar drejtë veprimet ankuesit si shkelje të rëndë disiplinore siç përcaktohet me nenin 6 paragrafin 1 pika 1.10 të Rregullores Nr.04/2011 për procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, rrjedhimisht Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 67 paragrafi 2 dhe nenit 71 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: *"Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. të dëgjojë provat lidhur me shkeljen e supozuar; 1.2. të vendosë, në bazë të proeveve, nëse është kryer shkelja; dhe 1.3. përcakton dënimin që duhet shqiptuar".**

Bazuar në rrethanat si me sipër, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Agjencisë Pyjore të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Ref:SBNJD-107/2020 të datës 14.04.2020 më të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike lidhur me çështjen në vendosje.

Andaj, duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila mendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.304/2022

Elakron Gashi

  
Procesmbajtës



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjor të Kosovës;
- Menaxherit të Personelit në Agjencinë Pyjore të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK- së.

